ISBN 978-9928-346-13-1

9 789928 346131

DIGAT KRYESORE NË SHQIPËRI / MAIN DAMS IN ALBANIA



DIGAT KRYESORE NË SHQIPËRI
MAIN DAMS IN ALBANIA

DIGAT KRYESORE NË SHQIPËRI
MAIN DAMS IN ALBANIA

Shtypur në shtypshkronjën e Shtëpisë Botuese FLESH
Tiranë, 2021

Autorë / Authors

Arjan Jovani

Gjergji Thomai

Luljeta Fortuzi

Fatjon Shaha

Fotografët Kryesorë / Main Photographers

Roland Tasho

Arjan Jovani

Arlind Braha

Perpunoi/ Edit

Irma Xibri

Redaktor gjuhësor / Language editor

Lindita Kazazi

Fotografia e kapakut të librit: pamje e digës së HEC Koman

Photo of album cover: View of dam in HEPP Koman

ISBN: 978-9928-346-13-1

PËRMBAJTJA / CONTENT

ANEKSET / ANNEXES

Parathënie

Shqipëria është një vend shumë i pasur me ujë i cili për vet rëndësinë jetike që ka, kërkon një shfrytëzim, monitorim dhe kujdes te veçantë për administrimin dhe përdorimin me sukses dhe pa pasoja të këtyre burimeve ujore sipërfaqësore. Vendi ynë është i ndarë në 7 basene lumore ku rrjedhin ujrat e 39 lumenjve kryesorë. Ata shkarkojnë mesatarisht afro 1250 m^3/s (40 miliard m^3 ujë në vit) në Detin Adriatik dhe detin Jon.

Shqipëria me sipërfaqen e përgjithshme prej 28 748 km^2 është një vend malor ku 70% përbëhet nga malet dhe kodrat.

Territori hidrografik i Shqipërisë ka një sipërfaqe prej 44 000 km^2 ose 57% më shumë se territori shtetëror i vendit. Në territorin hidrografik të saj bien afro 1400 mm shi në vit dhe në lartësitë 1000 m mbi nivelin e detit bien rreshje dëbore. Për arsye të shpërndarjes jo uniforme të rreshjeve gjatë vitit edhe prurjet e lumenjve kanë ndryshime të mëdha. Rreth 70% e prurjes vjetore të lumenjve tanë derdhet në periudhën ujëshumë dhe 30% derdhet në periudhën ujëpakët.

35% e prurjeve mesatare të ujit të këtyre lumenjve përdoren për prodhim energjie ujore dhe afro 1 miliard m^3 ujë përdoren për ujitje të afro 360 000 ha tokë bujqësore.

Një rol shumë të rëndësishëm në administrimin e këtyre ujrave luajnë digat e ndërtuara në disa lumenj të vendit, të cilat përdoren për prodhimin e energjisë ujore, furnizimit me ujë të pijshëm, ujitjet e tokave, mbrojtjen nga përmbytjet, rritjen e peshkut, transportin ujor dhe zhvillimin urban. Deri më sot në Shqipëri janë ndërtuar në total afro 652 diga të mëdha dhe të vogla.

Sipas Rregjistrit Kombëtar të Digave të Mëdha të hartuar dhe aprovuar nga Komiteti Kombëtar i Digave të Mëdha (KKDM), në vendin tonë aktualisht janë **351 diga të mëdha** të përcaktuara sipas Ligjit Nr.8681, datë 02.11.2000 "Për projektimin, Ndërtimin, Shfrytëzimin dhe Mirëmbajtjen e digave dhe Dambave".

Preface

Albania is a country very rich in water which, for its vital importance, requires an exploitation, monitoring and care for the successful administration and use of these resources without consequences. Our country is devided into 7 rivers basins where the water of 39 rivers flow. They discharge on average about 1250m^3 / sec (40 billion m^3 of water per year) in the Adriatic Sea and the Ionian Sea.

Albania with a total surface of 28 748 km^2 is a highland country where 70% consists of mountains, hills, lakes and rivers

The hydrographic territory of Albania has a surface of 44,000 km^2 or 57% more than national area of our country. In its hydrographic territory it falls about 1 400 mm of rain per year. It snows in the height over 1 000 m. Due to the non-uniform distribution of rainfall during the year, river flows have large changes. About 70% of the annual inflow of our rivers flows in the winter period and 30% flows in the warm period.

35% of the average water inflows of these rivers are used for hydro power production and approx. 1 billion m^3 of water is used for irrigation of about 360,000 ha of agricultural land.

A very important role in the management of these waters play the dams built in several rivers of the country which are used for hydro power production, drinking water supply, land irrigation, flood protection, fish farming, water transport and development urban. Till now, about 652 large and small dams have been built in Albania.

According to the National Register of Large Dams prepared and approved by the National Committee of Large Dams (KKDM), in our country there are currently **351 large dams** defined by Law No.8681, dated 02.11.2000 "On design, construction, use and Maintenance of Dams and Dams".

Sipas Rregjistrit të ICOLD, Shqipëria është në vendin e 19 në botë për numrin e përgjithshëm të digave të mëdha dhe renditet në vendin e parë në Europë për numër të digave të mëdha për 1000 km^2 si dhe për numër të digave të mëdha për 1 milion banorë.

24 diga të mëdha përdoren për prodhim energjie ujore, 325 diga të mëdha përdoren për ujitje, dhe 2 diga të mëdha përdoren për furnizim me ujë të pijshëm.

Në Shqipëri aktualisht janë 10 diga shumë të mëdha me lartësi mbi 60 m dhe 3 Kaskada kryesore të ndërtuara në lumenjte Drin, Devoll dhe Mat të cilat shfrytëzohen dhe përdoren për prodhim hidroenergjie dhe ujitje. Njëkohësisht, ato janë digat me rrezikun më të lartë për dëmtime në ekonomi dhe humbje në njerëz në rastet e ndonjë ngjarje natyrore katastrofike apo prishje të mundshme të ndonjë dige. Sipas analizave të rrezikut të kryera nga eskpertë vendas dhe të huaj, digat e mëdha me rrezikun më të madh për humbje në njerëz janë digat e tre kaskadave të mësipërme të ndërtuara në lumin Drin, Mat dhe Devoll.

Të gjitha digat e mëdha janë objekte të rëndësisë së veçantë dhe kërkojnë marrjen e tërësisë së masave organizative, teknike dhe financiare që të garantojnë shfrytëzimin normal të tyre, jetëgjatësinë më të madhe dhe moscënimin e të tretëve në fazën e ndërtimit, shfrytëzimit dhe mirëmbajtjen e tyre.

Digat e mëdha përdoren nga 65 operatorë të ndryshëm, ku 55 prej të cilëve janë pushtete lokale (Bashki) dhe 8 operatorë jane kompani private.

Prej Vitit 1964, Shqipëria është antare me të drejta të plota në Komisionin Ndërkombëtar të Digave të mëdha (ICOLD), ku merr pjesë dhe jep kontributin e saj zyrtar në mënyrë aktive në të gjithë proceset e bashkëpunimit teknik dhe institucional me aktorët ndërkombëtare të këtij sektori.

According to the ICOLD Register, Albania is in 19th place in the world for the total number of large dams and is ranked first in Europe for the number of large dams per 1000 km2 and for the number of large dams for 1 million inhabitants.

24 large dams are used for hydro power production, 325 large dams are used for irrigation, and 2 large dams are used for drinking water supply.

In Albania there are currently 10 very large dams with a height of over 60 m and 3 main cascades built on the rivers Drin, Devoll and Mat which are used and used for hydro power and Irrigation. At the same time, they are the dams with the highest risk of damage to the economy and loss of people in the event of a catastrophic natural event or possible breakdown of a dam. According to risk analyzes performed by foreign and domestic experts, large dams with the highest risk of loss to humans are the large dams built on the Drin, Mat and Devoll rivers.

All large dams are objects of special importance and require the taking of all organizational, technical and financial measures to guarantee their normal use, longer life and non-intrusion of third parties in the phase of construction, use and maintenance.

Large dams are operated by 65 different operators where 55 of which are local governments (Municipalities) and 8 Operators are private companies.

Since 1964, Albania is a full member of the International Commission of Large Dams (ICOLD) where it participates and gives its official contribution actively in all processes of technical and institutional cooperation with international actors in this sector.

Komiteti Kombëtar Shqiptar i Digave të Mëdha (ALBCOLD)

Komiteti Kombëtar Shqiptar i Digave të Mëdha (KKDM) u formua në vitin 1964. Anëtarët e KKDM janë inxhinierë të të gjitha disiplinave të përfshira në kërkimin, projektimin, ndërtimin, monitorimin, operimin dhe administrimin e digave të mëdha dhe Rezervuarëve të krijuar prej tyre. KKDM është organ i Këshillit të Ministrave i cili ushtron kontrollin shtetëror mbi Sigurinë e Digave si objekte të një rëndësie të veçantë dhe përfaqëson shtetin shqiptar në Komisionin Ndërkombëtar të Digave të Mëdha (ICOLD).

KKDM është anëtar i ICOLD dhe i klubit rajonal europian të ICOLD, (EUROCOLD). Merr pjesë në aktivitetet e Komisionit Ndërkombëtar me praninë e anëtarëve të tij në asambletë vjetore, kongrese dhe grupe pune.

Misioni i KKDM është:

<u>Diga sa më të sigurta për njerëzit tanë dhe për një zhvillim të qëndrueshëm ekonomik të vendit tonë.</u>

Ky mision arrihet përmes:

- Mbështetjes dhe zhvillimit të progresit teknik në projektimin, ndërtimin, operimin, mirëmbajtjen dhe sigurinë e digave të mëdha në interes të zhvillimit ekonomik dhe shoqëror të vendit;
- Përcaktimit të rregullave për përdoruesit e digave të mëdha si dhe një qasjeje të sotme ndaj sigurisë së digave për të minimizuar rreziqet që mund të ndodhin nga aktivitetet e tyre;
- Forcimit të kapaciteteve teknike dhe monitoruese gjatë ndërtimit dhe përdorimit të digave dhe trajnimit të ekipeve të monitorimit dhe sigurisë së digave sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe rekomandimeve të ICOLD;
- Miratimit dhe kontrollit të planeve të gatishmërisë në rastet e emergjencave civile për diga të mëdha;
- Krijimit të një perspektive evropiane në drejtim të mirëmbajtjes, monitorimit dhe sigurisë së digave të mëdha. Zhvillimi i bashkëpunimeve me institucione të specializuara në sektorin e digave;

Albanian National Committee of Large Dams (ALBCOLD)

The Albanian National Committee of Large Dams (ALBCOLD) was formed in 1964. The members of ALBCOLD are Engineers of all disciplines involved in the research, design, construction, monitoring and operation of water storage and managements of large dams. ALBCOLD is a body of the Council of Ministers which exercises state control on Dams Safety as objects of special importance and represent the Albanian State in the International Commission of Large Dams (ICOLD).

ALBCOLD is a member of the ICOLD and of European regional club of ICOLD (EUROCOLD). It participates in the activities of the International Commission with presence of its members in the annual assemblies, the congresses and the works groups.

The mission of ALBCOLD is:

<u>Dams as safe as possible for our people and for a stable economic development of our Country.</u>

This mission we'll achieve through:

- Supporting and development of technical progress in the design, construction, operation, maintenance and safety of large dams in the interest of the country's economic and social development;
- Determining of the rules for the operators of the large dams and as well as a today's approach to the safety of dams in order to minimize the risks that can occur from their activities;
- Strengthening of technical and monitoring capacities during the construction and operation of dams and training of dam monitoring and safety teams according to the requirements of the legislation in force and ICOLD recommendations;
- Approval and control of preparedness plans in cases of civil emergencies for Large dams

- Informit për situatën aktuale të gjëndjes së digave në vendin tonë, zhvillimet në sektorin e digave në botë dhe rajon, si dhe promovimin e praktikave më të mira sa herë që është e mundur;
- Përmbushjes së rolit në mënyrë transparente, të parashikueshme dhe jodiskriminuese. Ndërgjegjësimi i organeve shtetërore dhe publikut për vlerat e shumta të digave të mëdha, por edhe për pasojat e mundshme në ekonomi dhe në njerëz në rast të ndonjë prishje të mundshme të tyre.

Detyrat kryesore të KKDM janë:

- Miratimi i projekt ideve dhe projekteve të detajuara të digave të reja si dhe projektet e riparimit dhe përmirësimit të digave ekzistuese që janë në përdorim;
- Kryerja e kontrollit fizik dhe dokumentar verifikues në diga gjatë ndërtimit dhe përdorimit të tyre.
- Organizimi dhe drejtimi i procesit për përgatitjen e të gjithë dokumentacionit ligjor dhe teknik që operon në diga, përfshirë planet e gatishmërisë në rastet e emergjencave civile.
- Ndërgjegjësimi i organeve shtetërore dhe publikut për vlerat e shumta të digave, por edhe për pasojat shumë të rënda në vlerat ekonomike dhe njerëzore në rast të ndonjë prishje të mundshme të tyre.
- Informimi i Këshillit të Ministrave për gjendjen aktuale të digave/dambave dhe dhënia e mendimeve për procesin normal të monitorimit dhe përmirësimit të tyre në kohë.
- Miratimi i Kritereve për Licencimin e projektuesve dhe ndërtuesve të digave dhe dambave.
- Organizimi i shkëmbimit të të dhënave dhe eksperiencës ndërmjet KKDM dhe Komiteteve të digave të vendeve të tjera nëpërmjet organizatave dhe ekspertëve të specializuar brenda dhe jashtë vendit.

- Creating a European perspective in the direction of the maintenance, monitoring and safety of large dams. Development of collaborations with specialized institutions in the dam sector;
- Information about the current situation of dam conditions situation in our country, developments in the dam sector in the world and the region, as well as the promotion of best practices whenever possible;
- Fulfilling our role in a transparent, predictable and non-discriminatory way. Awareness of state bodies and the public about the multi values of large dams, but also for the possible consequences in the economy and a people in the case of their failure.

Main Tasks of ALBCOLD are:

- Approves Project ideas and Detail Designs of new dams as well as projects of repairing and improvement of existing dams and dykes which are in use;
- Perform the verifying physical and documentary control in dams during their construction and operations.
- Organizing and leading the process for preparing of all legal and technical documentation that operates in dams and dykes, including preparedness plans in cases of civil emergencies.
- Awareness of state bodies and the public about the multi values of dams and dykes, but also for the very serious consequences in economic and human values in the event of their failures.
- Inform the Council of Ministers for the actual conditions of dams/dykes and gives the opinions on normal process of their monitoring and improvement in time
- Approves the Criteria for licensing of Design and Construction of dams and dykes
- Organization of data exchange and experience between ALBCOLD and dams committees of other countries through experts and specialized organizations within and outside the country

- Pjesëmarrja në aktivitetet e ICOLD që përfaqësojnë shtetin shqiptar, si dhe përmbushjen e detyrimeve teknike dhe financiare ndaj ICOLD.

Komiteti Kombëtar Shqiptar i Digave të Mëdha (KKDM) përbëhet nga 11 anëtarë dhe mblidhet rregullisht gjatë gjithë vitit nën drejtimin e Kryetarit për të marrë vendime në lidhje me të gjitha funksionet dhe detyrat e ngarkuara sipas legjislacionit në fuqi.

Për realizimin e detyrave të tyre, KKDM mbështetet nga Këshilli i Përhershëm Teknik i Digave të Mëdha (KPTD) si organi i tij këshillues.

Sekretariati Kombëtar i Digave të Mëdha (SKDM) si zyra ekzekutive e KKDM funksionon në varësi të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë. SKDM ndjek veprimtarinë kontrolluese të projektimit, ndërtimit dhe përdorimit të digave dhe dambave të mëdha si dhe arkivimin e dokumenteve teknike.

Inspektorati Teknik i Digave (ITD) është një organ që ushtron kontroll gjatë ndërtimit, operimit dhe mirëmbajtjes së digave. ITD është pjesë e strukturës së SKDM.

Struktura organizative e KKDM është përcaktuar në ligjin nr.8681, datë 02.11.2000 "Për projektimin, ndërtimin, përdorimin dhe mirëmbajtjen e digave" përditësuar më 14.02.2013.

- Participation in ICOLD activities representing the Albanian state as well as fulfilling of technical and financial obligations to ICOLD.

The Albanian National Committee of Large Dams (ALBCOLD) consists of 11 Members and regularly meets throughout the year under the direction of its Chairman to make decisions regarding all functions and duties charged under the legislation in force.

For the realization of their tasks, The ALBCOLD is supported by the Permanent Technical Council of Large Dams (PTC) as its advisory body.

The National Secretariat of Large Dams (NSLD) as the executive office of ALBCOLD operates under the Ministry of Infrastructure and Energy. It follows the controlling activity of the design, construction and using of large dams and dykes and archives of technical documents.

The Technical Inspectorate of Dams and Dykes (TID) is an body that exercises control during the construction, operation and maintenance of dams. TID is part of the structure of NSLD.

Organizational Structure of ALBCOLD is defined in Law No. 8681, date 02.11.2000 "For design, construction, use and maintenance of dams and dykes" updated on 14.02.2013



Më shumë informacion mbi digat e mëdha në Shqipëri, KKDM dhe aktivitetet e saj mund të gjenden në faqen e internetit: www.albcold.gov.al

For the further information on large dams of Albania, ALBCOLD and its activities can find at web page: www.albcold.gov.al

Projektimi dhe Ndërtimi i Digave në Shqipëri

Shqipëria për arsye të kushteve historike, filloi projektimin dhe ndërtimin e digave të mëdha pas luftës së dytë botërore. Përfundimi i kësaj lufte e gjeti Shqipërinë një vend agrar dhe të prapambetur pa asnjë lloj industrie apo institucione projektimi. Varfëria dhe analfabetizmi ishin shtrirë në të gjithë vendin. Në këtë kohë, Shqipëria prodhonte vetëm 5 kwh për banorë dhe sipërfaqja e ujitur ishte afro 29 000 ha. Në vend, mungonte jo vetëm përvoja dhe tradita por edhe teknikët, specialistët dhe inxhinierët në fushën e ndërtimit të digave dhe të HEC-eve.

Historia moderne e digave të mëdha në Shqipëri filloi në vitin 1951 me përgatitjen e disa skemave dhe studimeve të shfrytëzimit të lumenjve Drin dhe Vjosë për qëllime të prodhimit të hidroenergjisë dhe të ujitjes së tokave bujqësore.

Në vitin 1952 filluan punimet për ndërtimin e digës së parë në vend që është diga e HEC Ulëz. Punimet filluan në bazë të një projekti të përgatitur nga Instituti "Hidroenergoproject", Leningrad, ish-BS.

Punimet filluan me ndërtimin e një rruge që lidhte qytetin e Milotit me vëndin ku do të ndërtohej diga. Më pas u vazhdua me ndërtimin e objekteve të përkohshme që do të shërbenin për ndërtimin e digës dhe nënobjekteve të tjera të HEC. Në vitet 1954 - 1955 u kryen punimet për devijimin e lumit dhe filluan punimet për betonimet në anën e majtë të shtratit. Për herë të parë u përdoren kallëpe druri të parapërgatitur me sipërfaqe deri në 20 m^2 që përdoreshin 20-30 herë. Blloqet e pilave mbi pjesën kapërderdhëse të digës u betonuan njëherësh me lartësi 11 m duke shkurtuar kohën e përfundimit të punimeve në digë. Në nëndor 1957 u mbyllën portat dhe filloi krijimi i ujëmbledhësit të HEC Ulëz me volum të projektuar prej 240 milion m^3 ujë. Për ndërtimin e kësaj digë punuan më se 3000 punëtorë, teknikë dhe inxhinierë shqiptarë të drejtuar nga inxh. Rrahman Hanku dhe Emin Musliu si drejtorë të punimeve dhe Hysni Dine dhe Mice Veshi

Design and Construction of large dams in Albania

Albania, due to historical conditions, started designing and construction of large dams after the second world war. The end of this world war, found Albania an agrarian and backward country without any kind of industry or design institutions. Poverty and illiteracy were widespread throughout the country. At this time, Albania produced only 5 kWh per capita and the irrigated area was about 29,000 ha. In the country, there was a lack not only of experience and tradition but also of technicians, specialists and engineers in the field of dam construction and HEPP

The modern history of large dams in Albania began in 1951 with the preparation of several sketches and schemes of exploitation of the Drin and Vjosa rivers for the purpose of hydro-power production and irrigation.

In 1952, the works for the construction of the first dam in the place that is the dam of HEPP Ulza started. The works started on the basis of a project designed by the Institute "Hidroenergoproject", Leningrad, BS

The works started with the construction of a road that connected the city of Milot with the place where the dam would be built. Then the construction of temporary facilities that would serve for the construction of the dam and other sub-facilities of HEPP was continued. In the years 1954 - 1955 the works for the diversion of the river were carried out and the works for the concreting on the left side of the bed started. For the first time, prepared wooden molds with surfaces up to 20 m2 were used, that were gone to be used 20-30 times. A lot of concrete blocks on the spillway parts of the dam were concreted at a height of 11 m, shortening the time of completion of works on the dam. In november 1957, the gates were closed and the filling of the HEPP Ulez reservoir with a volume of 240 million m3 of water began. For the construction of this dam worked more than 3000 workers, Albanian technicians and engineers led by engineers: Rrahman Hanku and Emin Musliu si Kryeinxhinierë të punimeve të zbatimit. Diga e HEC Ulzës me lartësi 64 m është digë betoni me gravitet.

Në vitin 1957 filluan punimet për ndërtimin e digës së liqenit artificial të Tiranës me lartësi 17 m, gjatësi të kreshtës së digës prej 510 ml dhe vëllim prej 110 000 m^3. Kjo digë është ndërtuar bazuar në projektin zbatimit të hartuar nga inxhinierët shqiptarë Fahredin Nuri dhe Thoma Filipeu. Diga është e tipit digë homogjene prej dheu. Ndërtimi i digës është bërë me punë vullnetare nga të rinjtë nxënës dhe studentë të Tiranës dhe ka përfunduar në vitin 1959.

Për ti paraprirë ndërtimit të digave në të ardhmen, në vitin 1957 u krijua pranë Ministrisë së Ndërtimit, Instituti Shtetëror i Projektimeve (ISHP), i cili ishte baza e krijimit në të ardhmen i Institutit të Studimeve dhe Projektimeve Hidroteknike Nr.3 (ISPH Nr.3) dhe Institutit të Studimeve dhe Projektimit të Veprave Kullim dhe Ujitje (ISPVKU). Këto Institute projektimi do të mbështeteshin nga Drejtoria e Gjeologji dhe Gjeodezisë e krijuar në vitin 1961, Instituti i Hidrometeorologjisë i krijuar në vitin 1962 dhe Qëndra e Kërkimeve Hidraulike e krijuar në vitin 1968.

Bazuar në eksperiencën e krijuar, në vitet 1961-1970 janë projektuar dhe ndërtuar afro 104 diga të mëdha për ujitjen e tokave bujqësore dhe për prodhimin e hidroenergjisë. Ndër më kryesoret, mund të përmenden digat e HEC Shkopet (1958-1963), Diga e HEC Bistrica (1958-1964), Diga e Kurjanit (1958-1962), Diga e Murriz Thanë (1959-1962), Diga e Tarinit (1958- 1962), Digat e Tapizës (1961-1964), Digat e HEC Vau i Dejës (1967-1971).

Detyra kryesore e projektuesve dhe inxhinierëve të ISPH Nr.3 ishte studimi dhe projektimi i digave dhe objekteve të Hidrocentraleve të kaskadës së lumit Drin. Kjo detyrë ishte një prej sfidave më të mëdha të kohës për të bërë të mundur shfrytëzimin e potencialit hidroenergjitik të lumit Drin, i cili përbënte pasurinë më të madhe të vendit tonë.

as general directors of works and Hysni Dine and Mice Veshi as Chief Engineers of civil works. The dam of HEPP Ulza with a height of 64 m is a concrete dam with gravity.

In 1957, the works for the construction of the artificial lake dam of Tirana with a height of 17 m, the length of the dam crest of 510 ml and a volume of 110,000 m3 began. This dam was built based on the detail project designed by Albanian engineers Fahredin Nuri and Thoma Filipeu. The dam is the homogeneous earth dam type. The construction of the dam was done by volunteer work of the young pupils and students of Tirana city and was completed in 1959. The dam and the reservoir created by it serves as a tourist and urban attraction of the Tirana city.

To precede the construction of large dams in the future, in 1957, the National Institute of Research and Design was established at the Construction Ministry, which was the basis of the Institute of Hydro Technical Studies and Designs No.3 (ISP No.3) and Institute for Studies and Design of irrigation and drainage systems (ISPVKU). These institutes will to be supported by the Directorate of Geology and Geodesy established in 1961, the Institute of Hydro-meteorology established in 1962 and the Hydraulic Research Center established in 1968.

Based on the experience created, in the years 1961-1970, about 104 large dams were designed and built for irrigation of lands and for the production of hydropower. Among the main ones, we can mention the dams of HEC Shkopet (1958-1963), the dam of HEC Bistrica (1958-1964), the dam of Kurjan (1958-1962), the dam of Murriz Thane (1959-1962), the dam of Tarin (1958- 1962), Tapiza Dams (1961-1964), dams of HEC Vau i Dejes (1967-1971), etc.

The main task of the designers and engineers of ISP was to study and design the dams and facilities of the Hydro power Plants of the Drin River Cascade. This task was one of the biggest challenges of the time to make possible the use of the hydro power potential of the Drin River which was the greatest asset of our country.

Deri në vitin 1960 nga disa studime paraprake që ishin kryer për shfrytëzimin e lumit Drin, mbizotëronte mendimi i shfrytëzimit të këtij lumi me diga me lartësi jo më shumë se 60 m të larta për shkak të kapaciteteve teknike, ekonomike dhe logjistike të kohës. Një shfrytëzim i tillë rezultonte të ishte jo ekonomik dhe kërkonte një kohë të gjatë ndërtimi si dhe moslejimin e krijimit të ujëmbledhësve të mëdhenj. Krijimi i ujëmbledhësve të mëdhenj do të krijonin mundësine e një rregullimi të plotë vjetor të prurjeve të lumit Drin dhe menaxhim të mirë të këtyre prurjeve gjatë vitit për të prodhuar energji elektrike gjatë gjithë vitit. Studimi filloi në vitin 1961 dhe në vitin 1963 u miratua nga Qeveria.

Until 1960, from some preliminary studies that were carried out for the exploitation of the Drin River, the opinion of the exploitation of this river with dams not higher than 60 m high prevailed due to the technical, economic and logistical capacities of the time. Such exploitation turned out to be uneconomical and required a long construction time as well as not allowing the creation of large reservoirs. The creation of large reservoirs would create the possibility of a complete annual regulation of the Drin River inflows and good management of these inflows during the year to produce electricity throughout the year. The study began in 1961 and in 1963 was approved by the Government.

Ky studim u drejtua me profesionalizëm, kompetencë dhe dije nga **Prof. Petrit Radovicka,** i cili ka qenë edhe Kryetar i parë i Komitetit Kombëtar të Digave të Mëdha në vitin 1964.

This study was conducted with professionalism, competence and knowledge by **Prof. Petrit Radovicka** who was also the first Chairman of the Albanian National Committee of Large Dams in 1964.

Që në fillim të studimit për shfrytëzimin e potencialit hidroenergjitik të lumit Drin u pranua idease lumi Drin duhej të shfrytëzohej duke krijuar ujëmbledhës të mëdhenj. Për krijimin e këtyre ujëmbledhësve kërkohej të projektoheshin dhe të ndërtoheshin diga shumë të larta me lartësi 60 - 170 m. Në vitin 1962 në Europë ishin ndërtuar vetëm 10 diga me lartësi mbi 160 m. Kjo ide nuk ishte e lehtë të konceptohej dhe jo më të projektohej dhe të ndërtohej në atë kohë në Shqipëri.

From the beginning of the study on the exploitation of the hydro power potential of the Drin River, the idea was accepted that the Drin River should be exploited by creating large reservoir. For the creation of these reservoirs it was required to design and build very high dams with a height of 60-170 m. In 1962 in the Europe were built only 10 dams with a height of over 160 m. This idea was not easy to conceive and no longer to be designed and built at that time in Albania.

Duke u mbështetur në arritjet e shkencës dhe teknikës në botë për ndërtimin e digave të mëdha si dhe në profesionalizmin, vendosmërinë dhe besimin në vlerat tekniko - shkencore të projektuesve dhe inxhinierëve shqiptare u bë e mundur të zgjidhen me sukses të gjitha problemet që dolën gjatë projektimit dhe ndërtimit të këtyre digave dhe krijimit të kaskadës më të madhe në vendin tonë. Në bazë të studimit të miratuar, potenciali teknik i lumit Drin do të shfrytëzohej përmes ndërtimit të 5 Hidrocentraleve me një fuqi totale të projektuar prej afro 1 700 MGW. Këto HEC-e do të përdornin 4 ujëmbledhës me sipërfaqe prej afro 200 km^2 të krijuar nga 7 diga të mëdha. Gjatë studimit të

Relying on the achievements of science and technology in the world for the construction of large dams as well as the professionalism, determination and belief in the technical-scientific values of Albanian designers and engineers it became possible to successfully solve all the problems that arose during the design and construction of these dams and the creation of the largest cascade in our country. Based on the approved study, the technical potential of the Drin River would be exploited through the construction of 5 hydro power plants with a total power of about 1 700 MGW. These HEPPs would use 4 reservoirs with an area of about 200 km2 created by 7 large dams. During the study skemës së shfrytëzimit të lumit Drin janë patur paraysh zgjidhja e problemeve të ndryshme që lidheshin me kushtet gjeologjike të zonës, tipit të digës, materialeve të ndërtimit dhe kohës së ndërtimit të tyre.



Skema e Shfrytëzimit hidroenergjitik të Lumit Drin

Aktualisht mbi lumin Drin janë ndërtuar 6 diga të mëdha (4 Digat e HEC Vau i Dejës me lartësi 12-60 m, Diga e HEC Fierzës me lartësi 166.5 m dhe Diga e HEC Koman me lartësi 115.5 m) dhe është në fazën e projektimit diga e HEC Skavicës. Gjithashtu, në pjesën e poshtme të rrjedhës së lumit është ndërtuar edhe Kompleksi hidroteknik i HEC Ashta dhe Spatharës.

Bazuar në kushtet dhe mundësitë tekniko - ekonomike, ndërtimi i digave të kaskadës së lumit Drin filloi në janar të vitit 1967 me ndërtimin e Kompleksit hidroteknik të HEC Vau i Dejës i cili përbëhet nga:

1- **Diga e Zadejës** me lartësi 60 m, gjatësi të kreshtës së digës prej 387 m dhe volum i trupit të digës prej 3.1 milion m^3. Kjo digë është e tipit me zhavorr dhe bërthamë argjile. Në anën e majtë të kësaj digë është ndërtuar sistemi i shkarkimit i përbërë nga 2 Portat dhe tuneli i shkarkimit me gjatësi L=322 ml dhe lartësi 11 m. Kapaciteti aktual i tij për shkarkimin e ujrave të tepërta është afro 2000 m^3/s.

2- **Diga e Qyrsaqit** me lartësi 54 m dhe gjatësi të kreshtës së digës prej 514 m. Kjo digë përbëhet nga 2 pjesë prej të cilave, pjesa e parë është digë me gurë

of the exploitation scheme of the Drin River, the solution of various problems related to the geological conditions of the area, the type of dam, construction materials, the time of their construction were taken into account.

Hydro- power Exploitation Scheme of Drini River

Currently, on the Drin River are built 6 large dams (4 dams of HEPP Vau i Dejes with height of 12-60 m, Dam of HEPP Fierza with a height of 166.5 m and Dam of HEPP Koman with a height of 115.5 m) and is in the design phase dam and HEPP Skavica. Also, In the downstream part of this river is constructed the hydro-technical complex of HEPP Ashta and Spathara.

Based on the technical-economic conditions and possibilities, the construction of the dams of the Drin river cascade started in january 1967 with the construction of the hydro-technical complex of HEPP Vau i Dejes which consists of:

1-Zadeja Dam with a height of 60 m, length of the dam crest of 387 m and a body volume of the dam of 3.1 million m3. This dam is of the type of rock-fill dam with clay cores. On the left side of this dam is built the discharge system consisting of 2 spillway gates and discharge tunnel with a length of 322 ml and height of 11 m. The current discharge capacity of this tunnel is about 2000 m3/s.

2-Qyrsaq Dam with a height of 54 m and a length of the dam crest of 514 m. This dam consists of 2 parts where the first part is a rock-fill dam with clay core and the second dhe bërthamë argjile dhe pjesa e dytë është digë betoni me gravitet. Në digën e betonit janë ndërtuar vepra e marrjes si dhe sistemi i shkarkimit sipërfaqësor me kapacitet total prej 3900 m^3/s.

3- **Diga e Rragamit** me lartësi 21 m dhe gjatësi të kreshtës së digës prej 240 m. Kjo digë është e tipit me zhavorr dhe bërthamë argjile.

4- **Diga e Gjocajt** me lartësi 11.2 m dhe gjatësi të kreshtës së digës prej 296 m. Në këtë digë ka një vepër marrje të ujit me kapacitet prej afro 8 m^3/s për furnizimin me ujë të kanalit të ujitjes së Rragamit.

Në gusht 1971 u mbyllën portat dhe filloi krijimi i ujëmbledhësit të HEC Vau i Dejës me volum të projektuar prej 580 milion m^3 ujë.

Punimet për ndërtimin e kompleksit hidroteknik të HEC Vaut të Dejës janë drejtuar nga inxh. Kristaq Glozheni (Drejtor në vitet 1967-1968), inxh. Emin Musliu (Drejtor në vitet 1968-1971), inxh. Gaqo Vasili (Kryeinxhinier në vitet 1967-1971).

Ndërtimi i këtij kompleksi u bë një shkollë e madhe e mësimit dhe përgatitjes profesionale të inxhinierëve, specialistëve dhe puntorëve. Mekanizimi i punimeve mori një zhvillim të paparë dhe ishte i niveleve më të përparuara të kohës. Kapaciteti i mjeteve dhe makinerive të përdorura ishin afro 700 000 kuaj fuqi. Intensiteti maksimal ditor i gërmimeve arriti deri në 8500 m^3/ dite, i mbushjes me gurë të digës arriti deri në 13 000 m^3/ditë dhe i betoneve deri në 1300 m^3/ditë.

Në nëntor të vitit 1971 filluan punimet për ndërtimin e digës së HEC Fierzë. Kjo digë është me lartësi 166.5 m dhe gjatësi të kreshtës së digës prej 380 m. Diga ka një volum të trupit të digës prej 8 milion m^3.

Për prodhimin e materialit mbushës të digës janë kryer 11 shpërthime masive me eksploziv duke arritur të sigurohen afro 500 000 m^3 gurë në çdo shpërthim. Ngarkimi i materialeve mbushës të digës është kryer me eskavator me kapacitet 2-4 m^3 dhe transporti i tyre është kryer me automjete

part is a concrete dam with gravity. In the concrete dam are also the intake system and the spillway system with a total capacity of 3900 m3/s.

3-Rragam dam with a height of 21 m and a length of the dam crest of 240 m. This dam is of the type of rock-fill dam with clay cores.

4-Gjocaj Dam with a height of 11.2 m and a length of of dam crest of 295 m. In this dam there is an intake system with a capacity of about 8 m3/s for the supply of the irrigation canal of Rragam

In august 1971, the gates were closed and the creation of the HEPP Vau i Dejes water reservoir began with a projected volume of 580 million m3 of water.

The works for the construction of the hydro-technical complex of HEPP Vau i Dejes were directed by Eng. Kristaq Gliozheni (Director in the years 1967-1968), Eng. Emin Musliu (Director in the years 1968-1971), Eng. Gaqo Vasili (Chief Engineer in the years 1967-1971).

The construction of this complex became a good school of teaching and professional training of workers, specialists and engineers. The mechanization of the works received an unprecedented development and was of the most advanced levels of the time. The capacity of the equipment and machinery used was about 700,000 horsepower. The maximum daily intensity of excavations reached up to 8500 m3 / day, of the filling with dam rock and stones reached up to 13 000 m3/day and of concrete up to 1300 m3 / day

In november 1971, the works for the construction of the dam of HEPP Fierza started. This dam with a height of 166.5 m, a length of the dam crest of 380 m. The dam body volume is 8 million m3.

For the production of dam filling material, 11 mass explosions with explosives were carried out, managing to provide about 500,000 m3 / stones in each explosion. Loading of dam filling materials was performed with excavators with a vetëshkarkuese me kapacitet 20 - 32 ton. Perdja e çimentimit e ndërtuar në aksin e digës është ndërtuar në thellësi deri në 100 m në shtratin e lumit dhe në gjatësi deri në 300 m në shpatullat e digës. Për ndërtimin e kësaj perde janë kryer më se 80 000 ml shpime dhe çimentime.

Në anën e majtë të digës ndodhen të gjitha veprat e shfrytëzimit të HEC Fierza dhe në anën e djathtë të saj ndodhen sistemet e shkarkimit të ujit me kapacitet total prej 2670 m^3/s.

Në shkurt 1978 u mbyllën portat dhe filloi krijimi i ujëmbledhësit të HEC Fierza me volum të projektuar prej 2.7 miliard m3 ujë.

Punimet për ndërtimin e kompleksit hidroteknik të HEC Fierza janë drejtuar nga inxh. Mice Veshi, Muhedin Muço, Kiço Negovani dhe Emin Musliu si drejtor të punimeve dhe inxh. Ismail Ahmeti si kryeinixhinier i punimeve.

Në vitin 1980 filluan punimet për ndërtimin e digës së HEC Koman. Kjo digë me lartësi 115.5 m, gjatësi të kreshtës së digës prej 275 m, kapacitet të shkarkimit të ujrave të tepërta prej 3600 m^3/s dhe volum të trupit të digës prej 5.7 milion m^3 ishte diga e parë në Shqipëri e tipit me gurë dhe ekran betonarme.
Zona e ndërtimit të digës, tuneleve të shkarkimit dhe tuneleve të marrjes së ujit përbëhet nga gëlqerorë pllakorë dhe shtresorë, gëlqerorë strallore me ndërthurje silicësh dhe straje me veti të larta qëndrueshmërie dhe fortësie.

Sfidat kryesore në projektimin dhe ndërtimin e kësaj dige dhe nënobjekteve të saj ishin zbatimi i teknologjive të reja në perden e çimentimit dhe në tunelet me përmasa të mëdha si dhe ndërtimi i ekranit betonarme.

Në anën e majtë të digës ndodhen të gjitha veprat e shfrytëzimit të HEC Koman si dhe një tunel i sistemit të shkarkimit të ujërave dhe në anën e djathtë të saj ndodhet një tunel i shkarkimit të ujit.

capacity of 2-4 m3 and their transport was performed with self-unloading trucks with a capacity of 20-32 tons. The grout curtain putted on the axis of the dam is built up to 100 m deep in the river bed and up to 300 m at the shoulders of the dam. There were carried out in total 80,000 ml of boring and cementing which fulfilled the high technical requests with percolating rate of 0.015 m/day.

On the left side of the dam are all the works of the Hydro Power plant and on its right side are the water spillway systems with total capacity of 2670 m3/s .

In february 1978, the gates were closed and the creation of the HEPP Fierza reservoir with a projected volume of 2.7 billion m3 of water began.

The works for the construction of the hydro-technical complex of HEPP Fierza have been directed by Eng. Mice Veshi, Muhedin Muco, Kico Negovani and Emin Musliu as general directors of works and Ismail Ahmeti as chief engineer of works.

In 1980, the works for the construction of the dam of HEPP Koman started. This dam with a height of 115.5 m, a length of the dam crest of 275 m, discharge capacity of 3 600 m3/s and a dam body volume of 5.7 million m3 was the first dam in Albania of the type with Concreted Face Rock fill Dam (CFRD).
The construction area of the dam and spillways and water intake tunnels consists of lime stone slab and layers, flint stone, interlacing with silica and stratification with high properties of strength and strength.

The main challenges in the design and construction of this dam and its sub-facilities were the application of new technologies in the grout curtain, construction of the large tunnels, and the construction of the reinforced concrete screen.

On the left side of the dam are all the works of the Hydro-power plant as well as a tunnel (Tunnel No.4) of the water spillway system and on its right side there is a water spillway tunnel (Tunnel No.3).

Në vitin 1986 u mbyllën portat dhe filloi krijimi i ujëmbledhësit të HEC Koman me volum të projektuar prej afro 500 milion m^3 ujë.

Punimet për ndërtimin e kompleksit hidroteknik të HEC Koman janë drejtuar nga inxh. Ismail Ahmeti, inxh. Fred Mustafaraj, inxh. Besnik Bekteshi, Inxh. Kujtim Bejtja.

Në vitet 1971-1990 janë projektuar dhe ndërtuar afro 232 diga të mëdha për ujitjen e tokave bujqësore. Ndër më kryesoret, mund të përmenden digat e Doftisë (1970 - 1974), Diga e Paskuqanit (1981 - 1983), Diga e Farkës (1981-1984), Diga e Janjarit (1984-1986).

Deri në vitin 1990, për projektimin e të gjithë digave të mëdha të përmendura më sipër ishin ngritur Institutet përkatëse të studimit dhe projektimit si: Instituti i Studimeve dhe Projektimit të Veprave Hidroteknike (ISP Nr.3), Instituti i Studimeve dhe Projektimeve të Veprave të Kullimit dhe Ujitjes, Instituti Gjeologji - Gjeodezi, Laboratori i Kërkimeve Hidraulike, Instituti i Hidrometerologjisë, etj. Në këto Institute kanë kontribuar dhjetra inxhinierë dhe specialistë të fushës ku mund të përmendim profesor Petrit Radovicka, Prof. Farudin Hoxha, Prof. Pandi Stratobërdha, inxh. Egon Gjadri, Gëzim Struga, Pandi Çezmaxhi, Foto Dhima, Stavri Peçi, Mete Hadëri, Enver Preza, Fahredin Nuri, Thoma Filipeu, Dhimitër Vogli, Milaim Dokle, Iljaz Cerga, Nezir Note, Murat Klosi, Nesti Lubonja, Vedat Shehu, Nuro Dhima, Lili Dhame, Kujtim Kadria, Marko Kamenica, Kujtim Shamata, Neço Goro, Agim Basha, Arjan Gjikondi, Kristo Goga, Fitim Balla, Vladimir Agalliu, Maks Muçi dhe shumë të tjerë të cilët krijuan plejadën e inxhinierëve të famshëm shqiptarë të digave.

Gjithashtu për studimet dhe përcaktimin e skemave të shfrytëzimit të lumenjve të tjerë ishte caktuar Katedra e Hidroteknikës në bashkëpunim me Fakultetin e Gjeologjisë pranë Universitetit Politeknik të Tiranës. Pedagogët e këtij Departamenti si Xhemal Gjata, Bestar Doko, Zenun Murataj, Luan Doda, Bardhyl Shehu përveç mësimdhënies për të kualifikuar inxhinierët e rinj të kësaj fushe përgatitën

In 1986 the gates were closed and the creation of the HEPP Koman reservoir with a projected volume of about 500 million m3 of water began.

The works for the construction of the hydro-technical complex of HEPP Koman are directed by eng. Ismail Ahmeti, eng.Fred Mustafaraj, eng.Besnik Bekteshi, eng.Kujtim Bejtja, etc.

In the years 1971-1990, about 232 large dams were designed and built for irrigation of agricultural lands. Among the main ones, we can mention the Dofti dams (1970-1974), Paskuqan Dam (1981-1983), Farka Dam (1981-1984), Janjar Dam (1984-1986), etc.

Until 1990, for the design of all the large dams mentioned above, the relevant Institutes of studies and designs were established, such as: Institute of studies and design of hydro-technical works (ISP No. 3), Institute of studies and design of drainage and irrigation systems (ISPVKU), Institute of Geology-Geodesy, Hydraulic Research Laboratory, Institute of Hydro-meteorology, etc. Dozens of engineers and specialists in the field have contributed to these Institutions, where Professor Petrit Radovicka, Prof. Farudin Hoxha, Prof. Pandi Stratoberdha, inxh. Egon Gjadri, Gezim Struga, Pandi Cezmaxhi, Foto Dhima, Stavri Peci, Mete Haderi, Enver Preza, Fahredin Nuri, Thoma Filipeu, Dhimiter Vogli, Milaim Dokle, Iljaz Cerga, Nezir Note, Murat Klosi, Nesti Lubonja, Vedat Shehu, Nuro Dhima, Lili Dhame, Kujtim Kadria, Marko Kamenica, Kujtim Shamata, Arjan Gjikondi, Kristo Goga, Vladimir Agalliu, Maks Muci, Agim Basha and many others who created the constellation of famous Albanian dam engineers.

Also for the studies and determination of the exploitation schemes of other rivers, the Hydrotechnical Department was appointed in cooperation with the Faculty of Geology at the Polytechnic University of Tirana. Professors of this Department such as Xhemal Gjata, Bestar Doko, Zenun Murataj, Luan Doda, Bardhyl Shehu, in addition to teaching to qualify young engineers in this field, also prepare schemes for hydropower utilization of all rivers in Albania except the edhe skemat e shfrytëzimit hidroenergjitik të të gjithë lumenjve të Shqipërisë përveç lumit Drin. Në vitin 1983 u aprovuan këto skema për t'u zbatuar në të ardhmen. Një prej këtyre skemave është edhe skema e shfrytëzimit hidroenergjitik i lumit Vjosë, e cila parashikonte ndërtimin e 8 digave të mëdha dhe fuqi të instaluar prej 490 MGW. Një studim tjetër i rëndësishëm ishte Vlerësimi i potencialeve teorike, teknike dhe ekonomike të shfrytëzimit të lumit Osum.

Në korrik të vitit 1986 filluan punimet për ndërtimin e digës së HEC Banjë, e cila ishte e projektuar nga ISP Nr.3 për t'u përdorur për ujitje dhe për prodhim të hidroenergjisë.

Në shkurt të vitit 1988 filluan punimet për ndërtmin e digës së Bovillës e cila fillimisht ishte projektuar për tu përdorur për prodhim hidroenergjie dhe ujitjen e tokave në zonën e Kamzës.

Për arsye të problemeve ekonomike e sociale të vendit si dhe mungesës së financimit, punimet për ndërtimin e digës së HEC Banjë dhe digës së Bovillës u ndërprenë në vitin 1991.

Në tetor të vitit 1993, bazuar në një projekt të ri të skemës së shfrytëzimit, të hartuar nga specialistë dhe inxhinierë italianë, rifilluan punimet për ndërtimin e digës së Bovillës me qëllimin për tu përdorur për furnizimin me ujë të pijshëm të qytetit të Tiranës. Kjo digë me lartësi 91 m, gjatësi të kreshtës së digës prej 135 m dhe volum të trupit të digës prej 650 000 mije m^3 ishte diga e parë në Shqipëri e tipit me gurë dhe gjeomembranë.

Zona e ndërtimit të digës, tunelit të shkarkimit dhe të marrjes se ujit përbëhet nga shkëmbinj karbonik të Kretakut të sipërm (CR2) dhe Paleogjenit të poshtëm dhe të mesëm (Pgl-2)

Sfidat kryesore në projektimin dhe ndërtimin e kësaj dige dhe nënobjekteve të saj ishin zbatimi i teknologjive të reja për elementin e papërshkueshmërisë (gjeomembranë në anën e sipërme të digës), perden e çimentimit dhe sistemin e marrjes së ujit.

river. In 1983 these schemes were approved to be implemented in the following years. One of these schemes is the scheme of the hydro power utilization of the Vjosa river which envisaged the construction of 8 large dams and an installed capacity of 490 MGW. Also, a important study is done for the evaluation of theoretical, technical and economical potentials of exploitation of Osumi River.

In july 1986, the works for the construction of the dam of HEPP Banja started, which was designed by ISP No. 3 to be used for irrigation and hydro-power production.

In february 1988, work began on the Bovilla Dam, which was originally designed to be used for hydropwer production and irrigation of lands in Kamza area.

Due to the economic and social problems of the country and the lack of funding, the works for the construction of the HEPP Banja dam and the Bovilla dam were stopped in 1991.

In october 1993, based on a new detail design prepared by Italian engineers, the works for the construction of the Bovilla dam resumed with the intention of being used for the supply of drinking water to the city of Tirana. This dam with a height of 91 m, length of the dam crest of 135 m and a dam body volume of 650 000 thousand m3 was the first dam in Albania of the type with rock fill and Geo-guaine PVC, thermal-accompanied with pattered polyester fibers, extended all over the surface of scrap and bound, along the contact perimeter with the natural ground, with the grout curtain.

The construction area of the dam and the spillway and water intake tunnel consists of Upper Cretaceous (CR2) Carboniferous rocks and Lower and Middle Paleogene (Pgl-2)

